

Vështrim i Përgjithshëm mbi Programin e Laptopit

Qëllimi i Programit: Të rrisë arritjet dhe pjesëmarrjen e studentit në një mjedis mësimor të shekullit XXI në të cilin çdo student ka një laptop për ta përdorur në shkollë dhe në shtëpi.

Objektivat e Programit:

- Të ndërtojë partneritet me prindërit për të siguruar një mjet të vlefshëm mësimi për studentët.
- Të krijojë një model të qëndrueshëm në mënyrë që BHS të mos mbeten prapa me teknologjinë.
- Të sigurojë opsione për studentët që zgjedhin të mos marrin pjesë.
- Të ofrojë ndihmë financiare për familjet në nevojë.

Vështrim i Përgjithshëm mbi Programin

- Drejtoria Arsimore aplikon një program financiar blerjesh me Apple.
- Prindërit/studentët e BHS bëjnë dy pagesa në vit për gjatë katër viteve dhe pastaj e blejnë pajisjen për \$1 + taksën mbi shitjen.
- Për studentët që nuk marrin pjesë në program ka në dispozicion laptopë që mund të huazohen.

Komponentët e Programit për Studentët

- Laptop MacBook Air.
- Software Akademike.
- Garanci 4-vjeçare AppleCare+ dhe Mbështetje Teknike në ambientet e BHS
- Mbulimi AppleCare+ përfshin dëmtimet aksidentale

Përdorimi i Laptopit nga Studenti:

- Mund ta përdorë në shkollë, shtëpi ose kudo.
- Mund të instalojë aplikacionet që dëshiron por kur është në shkollë duhet të respektojë Politikën e BHS për Përdorim të Pranueshëm.

Udhëzimet për Jo-Pjesëmarrësit

Programi “Laptop që mund të Huazohet”

Opsioni 1

Aksesi në Shkollë

- Në çdo klasë do të ketë në dispozicion një laptop që mund të huazohet. Ky laptop duhet të mbesë në klasë.
- Nuk mund ta marrësh në shtëpi laptopin që mund të huazohet. Dokumentet mund t'i ruash në Google Drive tënden ose në një shërbim tjetër “cloud” që të mund t'i aksesosh nga një pajisje tjetër e huazuar apo personale.

Aksesi në Shtëpi

- Laptopët “për t'u huazuar” gjenden në Bibliotekën Publike të Beverly.
- Pothuajse të gjitha dokumentet dhe programi mësimor mund të aksesohen nga shtëpia me një kompjuter me internet.

Macbook Personal

Opsioni 2

Kriteret për Pajisjen

- Duhet të jetë Mac me sistem operativ macOS. Në BHS nuk do të pranojmë pajisje me sisteme të tjera operative (Windows, Linux, Android...), sepse programi mësimor bazohet në Software MacOS
- Specifikimet e Rekomanduara: Macbook 2015 ose më i ri, RAM 8GB, SSD.

Përgjegjësitë:

- Printimi ofrohet në Qendrën e Teknikës në dhomën A171.
- Nëse shkelet Politika e Përdorimit të Pranueshëm do të hiqet akses në rrjet.
- Qendra e Teknikës ofron mbështetje të limituar për pajisje që nuk janë pjesë e programit të qirasë financiare.
- Për lëndë të caktuara mund t'ju duhet të blini software.

Pyetje që Bëhen Shpesh

Pyetje: Nëse shkoj dhe e blej vetë një MacBook, a nuk do të ishte opsion më i mirë?

Ne kemi krahasuar kostot dhe besojmë që duke konsideruar ato që merrni përgjatë 4 viteve ("shtesat" dhe garancinë 4-vjeçare), programi ynë i qirasë financiare është një opsion më i mirë që ju kushton më pak se po ta blinit direkt në Dyqanin Apple.

Pyetje: Unë kualifikohem për ndihmë financiare. Çfarë kërkohet?

Do t'ju kërkohet të paguani 60%, 40% ose 20% më lirë se vlera e plotë e qirasë financiare. Askush nuk do të marrë laptop falas. Ju lutemi kini parasysh që duhet të aplikoni çdo vit për ndihmën financiare.

Pyetje: Po nëse vendos të mos marr pjesë në programin e qirasë financiare dhe më vonë ndërroj mendje?

Do të keni mundësi t'i bashkoheni programit prillin e ardhshëm; megjithatë, ju lutemi kontaktoni qendrën e ndihmës për të pyetur nëse ka laptopë në gjendje.

Pyetje: Po nëse largohem nga BHS pa mbaruar periudha 4-vjeçare?

Keni opsionin ta blini laptopin duke paguar vlerën e mbetur të qirasë financiare ose t'ia ktheni shkollës në gjendje të mirë. Nëse largoheni nga BHS përpara se të mbarojë periudha e qirasë financiare e laptopit tuaj dhe vendosni ta blini, për riparime mund ta çoni në një Dyqan Apple ose një servis tjetër të autorizuar. Përgjatë periudhës 4-vjeçare të AppleCare+ nuk do t'ju duhet të paguani për riparimet që mbulohen garancia. Mundeni edhe ta sillni laptopin tek Qendra Teknike e BHS për ndihmë.

Pyetje: Dua të përdor MacBook-un tim?

- Macbook-u juaj duhet të plotësojë specifikimet minimale; shikoni faqen "Jo-Pjesëmarrësit". Çdo Macbook tek Dyqani Apple duhet të funksionojë.
- Duhet të pranoni të instaloni programe software akademike të BHS (falas) çdo vit.
- Mund t'ju duhet të blini software që i blen Drejtoria Arsimore për kompjuterat me qira.
- Nëse dëshironi mund ta blini vetë siguracionin; Drejtoria Arsimore nuk mban përgjegjësi.
- Nuk ka garanci që kompjuteri që do të bleni do të jetë gjithnjë kompatibël me programin.

Pyetje: Nuk dua të marr pjesë?

Do të ketë laptopa për t'u huazuar në dispozicion gjatë ditës së shkollës ose për ndihmë pas ditës së shkollës. Gjithashtu, laptopët për huazim gjenden në Bibliotekën Publike të Beverly.

Pyetje: Kur dhe si do ta marr laptopin tim?

Për këdo që ka dorëzuar Formularin e Regjistrimit dhe ka bërë Pagesën Fillestare laptopët do të shpërndahen në gusht. Për të marrë laptopin studenti duhet të vijë me një prind ose kujdestar. Në atë moment studenti do të mësojë si të logohet në laptop dhe si të kujdeset për të.

Pyetje: Çfarë software përfshihet me laptopin tim?

Kjo listë e software mund të ndryshohet në çdo kohë.

Pyetje: Nëse dikush e ka një Mac, a do të jetë në gjendje të abonohet për shtesat (siguracion, mirëmbajtje dhe software)?

Lista e plotë e shtesave është e disponueshme vetëm për studentët në programin tonë Një Laptop për Çdo Student.

Pyetje: Ç'loj laptopi do të marr?

Shikoni faqen e specifikimeve të laptopit. Ju lutemi kini parasysh që modeli i laptopit mund të ndryshojë. Ne duam të sigurohemi që do të ofrojmë raportin më të mirë performancë/kosto nga Apple. Vendimi përfundimtar do të merret më 1 gusht 2022.